27	Kërkesë për riparim dhe çarjet pjesore në muret rrethuese	Lekë/kërkesë	2.000
28	Kërkesë për shtrimin e oborreve me shtresë të hollë betoni	Lekë/kërkesë	2.000
29	Kërkesë për riparimin dhe zëvendësimin e ulluqeve dhe oxhaqeve	Lekë/kërkesë	2.000
30	Kërkesë për vendosjen e tendave të diellit	Lekë/kërkesë	2.000
31	Kërkesë për punimet civile për rrjetet ose sistemet e komunikimeve elektronike/telekomunikacioni (sipas pikës 1.4, neni 6, VKM 408,datë 13.05.2015)	Lekë/kërkesë	10.000
32	Kërkesë për ndërhyrje me qëllim ruajtjen apo rritjen e eficencës energjitike	Lekë/kërkesë	5.000

1. Të gjithë subjektet që regjistrohen për herë të parë prej datës 01.01.2026 e në vazhdim për vendosjen e tarifave vendore (gjelbërim, ndriçim, pastrim) do të bëhet vlerësimi nga zyra duke përdorur metoda alternative. Në përdorimin e metodave alternative të vlerësimit tatimor administrata tatimore vendore bazohet në dokumentacionin dhe informacionin që disponon, duke pasur parasysh faktet dhe rrethanat konkrete të biznesit, situatën e tatimpaguesve të tjerë të ngjashëm, me synim rikarakterizimin e transaksioneve dhe llogaritjen sa më të saktë të detyrimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.
Struktura e ngarkuar për përcaktimin e tarifave vendore (pastrim, ndriçim, gjelbërim) është Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Maliq.
Tarifat për Pastrim, ndriçim dhe gjelbërim janë detyrime vjetore të tatimpaguesit ekzistues dhe për ata që regjistrohen rishtaz për periudhën e mbetur deri në fund të vitit ushtrimor. Për vendosjen e tarifave vendore (pastrim, ndriçim, gjelbërim) do të bëhet vlerësimi nga zyra, ky vlerësim bazohet në dokumentacionin dhe informacionin që disponon, duke pasur parasysh faktet dhe rrethanat konkrete të biznesit, situatën e tatimpaguesve të tjerë të ngjashëm, me synim rikarakterizimin e transaksioneve dhe llogaritjen sa më të saktë të detyrimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

Afati i pagesës është brenda datës 30.06.2026 për subjektet e regjistruara dhe për subjektet që do të regjistrohen pas datës 30.06.2026 brenda 30 ditëve nga momenti i regjistrimit.
Të gjitha subjektet që do aplikojnë pranë Q.K.B për pushim të përkohshëm të aktivitetit nga data e aplikimit për pushim të përkohshëm të aktivitetit deri në datën e aktivizimit nuk do të përllogariten tarifat lokale.

Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me **0,06** për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.
Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifave për pastrim, ndriçim dhe gjelbërim për subjektet që ushtrojnë aktivitet ekonomik është Drejtoria e të Ardhurave e Bashkisë Maliq.
Përsa i përket kategorisë familje detyrimi vjetor do të shpërndahet për periudhën Janar – Mars 2026 dhe detyrimi vjetor për tarifat lokale do të paguhet pranë sporteleve të Bashkisë Maliq dhe

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

pranë sporteleve të njësive administrative për njësitë e tjera administrative brenda datës **30.09.2026.**

Përjashtohen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifave për pastrim, ndriçim dhe gjelbërim për familjarët rezidentë efektivë është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Maliq.

2. Përsa i përket tarifës për zënie hapësirë publike është detyrim mujor i tatimpaguesve. Derdhja e të ardhurave për këtë tarifë në favor të Bashkisë, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës. Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me **0,06** për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

   Përjashtohen nga pagesa për zënien e hapësirave publike të gjitha subjektet për muajt Janar, Shkurt, Mars, Nentor dhe Dhjetor.

   Ngarkohet grupi i punës i ngritur me urdher te Kryetarit me përfaqësi nga Drejtoria e Pronave dhe Drejtoria e të Ardhurave për ndjekjen, matjen dhe plotësimin e aktit të konstatimit për hapësirat publike të cilat shfrytëzohen nga subjektet private.

   Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave për llogaritjen e tarifës për secilin subjekt.

   Struktura e ngarkuar me penalitetet për moskryerjen e pagesës është Policia Bashkiake.

3. Përsa i përket tarifës për mirëmbajtjen e varrezave publike detyrimi vjetor do të shpërndahet për periudhën Janar – Mars 2026, dhe do të paguhet pranë sporteleve të Bashkisë Maliq dhe pranë sporteleve të Njësive Administrative.

   Përjashtohen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

   Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife për familjarët është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Maliq dhe Njësitë Administrative.

4. **Përcaktimi i vendndodhjes së biznesit.**

   Taksapaguesit biznes i vogël apo i madh janë të detyruar të paguajnë tarifat dhe taksat vendore mbi biznesin për çdo vendndodhje biznesi, në përputhje me nivelin e tarifave dhe taksave vendore të përcaktuar për llojin e biznesit sipas vendimit të Këshillit të Bashkisë.

   Bizneset nën administrimin e të njëjtit taksapagues që ushtrohen në një vendndodhje (në një godinë) do të taksohen dhe tarifohen gjithnjë si vendndodhje biznesi më vete. Një "*vendndodhje biznesi*" është një zonë e dallueshme dhe e ndarë si në të njëjtën godinë, ashtu edhe në godina të ndryshme, konkretisht:

   a) Kur veprimtari të ndryshme ekonomike kryhen nga një taksapagues në të njëjtën dhomë, konsiderohen si një vendndodhje e një biznesi.
   b) E njëjta veprimtari ekonomike e kryer nga një taksapagues në dy dhoma, që kanë komunikim nga brenda, konsiderohen një biznes, pra konsiderohen si një "*vendndodhje biznesi*".
   c) Dy veprimtari të ndryshme ekonomike të kryera nga një taksapagues në dy dhoma, që kanë komunikim nga brenda, konsiderohen dy biznese, pra konsiderohen si dy "*vendndodhje biznesi*".

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al